



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 30, Datë 29.01.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERDY ENERGY” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.15/1 prot., datë 26.01.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 208, datë 11.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/43 prot., datë 15.12.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ERDY ENERGY” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1232/1 prot., datë 11.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar ne ERE me nr. 1232/2, prot., datë 14.12.2020, ka përcjellë pjesërisht dokumentacionin e munguar dhe duke qenë se u konstatua sërish mungesë, ERE iu drejtua sërish shoqërisë me shkresën nr. 1232/3, prot., datë, 15.12.2020, duke i kërkuar të përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar në këtë aplikim.

- Shoqëria me shkresën nr. 105, datë 22.01.2021, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencën e tregtimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të Aneksit A, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ERDY ENERGY” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**